

DEKRET
Nr. 450, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

**Dhënien e dekoratës “Komandar i Urdhrit të Skënderbeut”
zotit Zyber Dushku**

“Në vlerësim të angazhimit jetëgjatë dhe të kontributeve të dalluara në transformimin rrënjësor të Forcave të Armatosura, të kapaciteteve organizuese dhe komanduese, të misioneve të përmbushura me sukses në cilësinë e Oficerit Madhor përgjegjës në një periudhë shumë sfiduese për sektorin ushtarak, si edhe për meritat e fituara në formimin akademik të gjithanshëm të disa brezave ushtarakësh”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj